

**ZGJIDHJA E TESTIT ME SKEMË PËR VLERËSIM TË PROVIMIT  
PROFESIONAL NË SHKOLLË TË MESME KATËRVJEÇARE  
PROFESIONALE, GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI, QERSHOR 2016**

1. Është rrethuar numri 2. *Për tjetërsimin e anëtarëve të qeverisë amerikane nga jeta e tyre private.* – **1 pikë**
2. Nxënësi/nxënësja\* merr **1 pikë** nëse përshkruan ose perifrazon fjalinë: *Do të ishte më mirë sikurse seminari do të ishte më i dobishëm.*
3. Është rrethuar numri 1. *Që t'i relaksojë dhe t'i nxisë në një sponatnitet.* – **1 pikë**
4. Është rrethuar numri 2. tregimi i fotografive

*Fotografitë vunë në lëvizje ndjenjat e dashurisë dhe butësisë për më të dashurit dhe nxitën kujtimet/Filluan t'i shkëmbejnë fotografitë dhe të bisedojnë për fëmijët e vet, nipat, domethënë për jetën e vet private (dhe përgjigje tjera të sakta) – 1 pikë për përgjigjen e rrethuar dhe të argumentuar saktë.*

*(Vërejtje: Nëse është rrethuar saktë, por nuk është argumentuar saktë përgjigjja ose nuk është shkruar fare argumentimi – 0 pikë.)*

5. Nxënësi merr **1 pikë** nëse përshkruan ose perifrazon tekstin: *“...shërben për depozitimin e jetës”/ për ruajtjen dhe depozitimin e jetës/Kuletat e tyre në të vërtetë janë vend çikërrimash ku gjenden gjërat e rëndësishme nga jeta e tyre private (dhe përgjigje tjera të sakta)*
6. **A) Mënyra dëshirore – 1 pikë**  
**B) Në kohën e pakryer – 1 pikë**
7. Është rrethuar numri 1. Vjollca – **1 pikë**

*Presja vendoset pas emrit Vjollca dhe në këtë rast shërben për të vënë në dukje fjalën në rolin e gjymtyre të veçuar*

*(Vërejtje: Nëse është rrethuar saktë, por nuk është argumentuar saktë përgjigjja ose nuk është shkruar fare argumentimi – 0 pikë.)*

8. **A) Raskolnjikovi – 1 pikë**  
**B) Të fillojë prej fillimit (dhe përgjigje tjera të sakta) – 1 pikë**

---

\*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

9. Përshkrimi i dhënë paraqet refleksionin e kryepersonazhit për ngjarjen e ndodhur dhe e arsyeton krimin nëse ai është bërë si rishikim i të qenit njeri (dhe përgjigje tjera të sakta) – **2 pikë**

Nxënësi merr **1 pikë** nëse tregon vetëm se përshkrimi i dhënë paraqet refleksionin e kryepersonazhit për ngjarjen e ndodhur dhe e arsyeton krimin pa sqaruar nëse ai është bërë si rishikim i të qenit njeri.

10. **A) Krimi dhe pasojat e tij – 1 pikë**  
**B) Metaforës – 1 pikë**

11. Është rrethuar numri 3. *Erdhi nga qyteti* – **1 pikë**

12. Nxënësi merr **1 pikë** për tri ose katër përgjigje të sakta:

D.M.TH. (d.m.th.)

OKB

NATO

ETJ. (etj.)

13. *Një numër sonetesh u shkruan nga Petrarka.* – **1 pikë**

14. **A) Nxënësi merr 1 pikë** për shkrimin e saktë të shkronjës së madhe:  
*Buzë detit Adriatik janë ndërtuar shumë plazhe të bukura, por edhe kasolla e Kuqos.*

- B) Është rrethuar numri 2. përemër – 1 pikë**

15. Është rrethuar numri 3. *nga lisi nuk e sheh pyllin* – **1 pikë**

16. Nxënësi merr **2 pikë** për rrethimin dhe argumentimin e saktë të përgjigjes:  
Është rrethuar PO.

Uniteti i veprimit ekziston sepse veprimi zhvillohet pa episode dhe digresion/Të gjitha ngjarjet lidhen me konfliktin dhe shpien në zgjidhjen e tij;

Uniteti i kohës ekziston sepse zhvillimi i Antigonës zgjat një ditë;

Uniteti i vendit ekziston sepse gjithçka zhvillohet në Ty.

(dhe përgjigje tjera të sakta) – **2 pikë** për rrethimin dhe argumentimin e saktë të përgjigjes.

Nxënësi merr **1 pikë** nëse e ka rrethuar saktë përgjigjen dhe ka argumentuar saktë dy unitete të dramës në vepër.

Nxënësi merr **0 pikë** nëse ka rrethuar saktë përgjigjen dhe ka argumentuar saktë një unitet të dramës në vepër.

(**Vërejtje:** Nxënësi **merr 1 pikë/2 pikë** nëse nuk e ka rrethuar PO, por e ka argumentuar saktë përgjigjen. Nxënësi e merr **1 pikë** nëse ka shkruar vetëm se ekziston uniteti i vendit, veprimet dhe kohës.)

17. Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigjen e plotë të saktë:

Mbështetja në realitetin e kohës e bën veprën sentimentaliste.	PO	JO
Romani Evgjëni Grande bën pjesë në komedinë njerëzore.	PO	JO
Romani Evgjëni Grande bën pjesë në romanet kalorsiakë.	PO	JO

18. **A)** Është rrethuar numri 3. *koprracia dhe ndikimi i saj te njeriu* – **1 pikë**  
**B)** *Miliona shkuan te kryetari!* – **1 pikë** (ose ndonjë shembull tjetër që arsyeton përgjigjen e saktë nën A)

19. Është rrethuar numri 3. *shpresë solemne* – **1 pikë**

20. *Fatkeqësia e Evgjënisë lidhet me mosrealizimin e dashurisë së saj dhe vuajtjen që ajo po përjeton nga sjellja e Karlit.* – **1 pikë**

21. Nxënësi merr **2 pikë** për tri ose katër përgjigje të sakta:

*Demka* - "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo", *Dritëro Agolli*

*Manolino* - "Plaku dhe deti", *Ernest Heminguej*

*Dr.Gj* - "Doktor Gjëlpëra", *Faik Konica*

*Oregoni* – "Tartufi", *Molieri*

Nxënësi merr **1 pikë** për dy përgjigje të sakta.

Nxënësi merr **0 pikë** nëse ka dhënë vetëm një përgjigje të saktë.

22. **A)** *Plaka Nicë personifikon nënat e martirizuara gjatë luftës* – **1 pikë**

**B)** *Vrasja e burrit dhe përdhunimi i vajzës* – **1 pikë**

23. Nxënësi merr **2 pikë** për pesë përgjigje të sakta:

1. *Epi i Gilgameshit*

2. *Komedia hyjnore*

3. *Tartufi*

4. *Albatrosi*

5. *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*

Nxënësi merr **1 pikë** për tri ose katër përgjigje të sakta.

Nxënësi merr **0 pikë** për një ose dy përgjigje të sakta.

24. Është rrethuar numri 3. *renesancës* – **1 pikë**

25. Është rrethuar numri 2. *metonimia*

Metonimia është figurë stilistike, kurse të tjerat janë lloje letrare  
(dhe përgjigje tjera të sakta) – **1 pikë**

(**Vërejtje:** Nxënësi merr **1 pikë** nëse nuk e ka rrethuar përgjigjen, por nga argumentimi është e qartë se mendon në Metonimi. Nëse është rrethuar saktë, por nuk është argumentuar saktë përgjigjja ose nuk është shkruar argumentimi **0 pikë**.)

26. Nxënësi merr **1 pikë** për tri ose katër përgjigje të sakta:

ROMANTIZMI	REALIZMI	LETËRSIA MODERNE
Aleksandër Sergejeviç Pushkin Johan Wolfgang Gëte	Honore de Balzak	Sharl Bodëler

27. A) Është rrethuar numri 1. *atdhe dhe familje* – **1 pikë**

B) Është rrethuar numri 3. *zhveshja nga ngjarjet e parëndësishme*  
– **1 pikë**

28. A) Këngë e Ciklit të Kreshnikëve (*krijim popullor*). – **1 pikë**

B) *Funksioni i hiperbolës këtu është që të theksohet që edhe përkundër gjendjes së Gjergj Elez Alia, ai del fitimtar mbi Bajlozin. (Merret e saktë edhe përgjigjja nëse nxënësi sqaron figurën e hiperbolës)* – **1 pikë**

29. A) *Publicistik* – **1 pikë**

B) Është rrethuar numri 3. *rruga e njohur* – **1 pikë**

C) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka përkthyer (ose ka nënvizuar në tekst):  
*Është një rrugë e cila kalonte pothuajse në trasenë e rrugës së vjetër “Egnatia”.*

(**Vërejtje:** **Nuk pranohet** nëse nxënësi përkthyer ose nënvizon të gjithë fragmentin.)

### 30. Skema për vlerësimin e intervistës

Përmbajtja	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura ndërtimore e tekstit
<p>Nxënësi merr <b>4 pikë</b> nëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ka shkruar hyrjen (titullin ose nëntitullin) me të cilin prezantohet bashkëbiseduesi/ shpjegon motivin e bisedës me të</li> <li>- ka menduar për tri deri në pesë pyetje dhe përgjigje lidhur me temën</li> <li>- pyetjet janë të qarta, thelbësore dhe me stil</li> <li>- përgjigjet janë më të gjata nga pyetjet, kanë të bëjnë me pyetjet dhe janë me stil</li> <li>- gazetari/ gazetarja në fund të intervistës e falënderon bashkëbiseduesin dhe i dëshiron sukses në punën e mëtejshme, planet dhe synimet e tij/ose jep përfundimin përkatës</li> </ul> <hr/> <p>Nxënësi merr <b>3 pikë</b> nëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- i ka menduar për tri deri në</li> </ul>	<p>respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, kongruencës, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale.</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores <b>ë</b>)</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 4 pikë</b></p> <hr/> <p>respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e</b></p>	<p>lidhshmëria e mirë në nivel të tekstit</p> <p><b>1 pikë</b></p>	<p>përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike të tij (i ndan qartë pyetjet nga përgjigjet sepse është intervistë për mediat e shkruara: pyetjet janë të nënvizuara/pyetjet janë shkruar me shkronja shtypi, kurse përgjigjet me shkronja dore/te pyetjet është theksuar emri i gazetës së shkollës ose është shkruar vetëm gazetari/gazetarja, kurse te përgjigjet mbiemri i bashkëbiseduesit p.sh. Valët: <i>pyetja e gazetarit</i>; Tagani:</p>

<p>pesë pyetje dhe përgjigje lidhur me temën</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- pyetjet janë të qarta, thelbësore dhe me stil</li> <li>- përgjigjet janë më të gjata nga pyetjet, kanë të bëjnë me pyetjet dhe janë me stil</li> </ul>	<p><b>cila, të cilët etj.)</b></p> <p><b>1 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta ( p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores <b>ë</b>)</p>		<p>përgjigjja etj.)</p> <p><b>1 pikë</b></p>
<p>Nxënësi merr <b>2 pikë</b> nëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- i ka menduar për tri deri në pesë pyetje dhe përgjigje lidhur me temën</li> <li>- pyetjet janë të qarta</li> <li>- përgjigjet janë më të gjata nga pyetjet dhe kanë të bëjnë me pyetjet</li> </ul>	<p><b>1 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>		
<p>Nxënësi merr <b>1 pikë</b> nëse pyetjet dhe përgjigjet janë të shkurtra dhe kanë të bëjnë me temën</p>			
<p>Nxënësi merr <b>0 pikë</b> nëse janë shkruar më pak se tri pyetje dhe përgjigje ose nëse pyetjet dhe përgjigjet nuk kanë të bëjnë me</p>			

temën			
-------	--	--	--